



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 17 gusht 2011
Nr. ref.: RK130/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI-35/11

Parashtrues

Unioni i Boshnjakëve të Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A-
U. Nr. 415/2010 të 27 majit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendës-kryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Subjekti politik Unioni i Boshnjakëve të Kosovës nga Reçani – Komuna e Prizrenit, të përfaqësuar nga kryetari i subjektit politik z. Raman Sagdati nga Reçani.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A-U. Nr. 415/2010 të 27 majit 2010, me të cilin hedhet poshtë ankesa e UBK-së ndaj vendimit të Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa(këtej e tutje: KZAP) A Nr. 87/2010 të 28 shkurtit 2010, me të cilin ishte miratuar ankesa e Zyrës për

Regjistrimin e Partive Politike (në tekstin e mëtejshëm: "ZRPPC") pranë Komisionit Qendror Zgjedhor (në tekstin e mëtejshëm: "KQZ") dhe me të cilin Unioni i Boshnjakëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "UBK") ishte gjobitur me shumën prej 1500 eurosh.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të 27 majit 2010, duke mos përmendur nenet konkrete të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por thjesht pohon se vendimi i KZAP-së A Nr. 87/2010 është konfuz dhe i paqartë. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ankohet se nuk i ishte dhënë mundësia që të deklarohen rreth ankesës së ZRPPC-së pasi që ankesa nuk i ishte dorëzuar. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se e drejta për ankesë është e drejta kushtetuese e cila u është shkelur.

Baza juridike

4. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejshëm: "Ligji") dhe Rregulli 56 (b) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Rregullorja e Punës").

Procedura në Gjykatë Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: "Gjykata") më 8 mars 2011.
6. Më 23 mars 2011 Gjykata Kushtetuese e njoftoi z. Raman Sagdatin se ka filluar procedura dhe se rasti është regjistruar me nr. 35-11.
7. Po të njëjtën ditë Gjykata Kushtetuese e ka njoftuar edhe KZAP-në dhe KQZ-në se numri i rastit është nr. 35-11 dhe se ishte inicuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë të vendimeve të tyre.
8. Më 18 prill 2011, me vendimin Nr. GJR. KI 35/11 të 18 prillit 2011), Kryetari e emëroi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues.
9. Po të njëjtën ditë, me vendimin Nr. KSH. KI35/11 Kryetari e emëroi kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Iliriana Islami.
10. Më 6 prill 2011 Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa e dërgoi përgjigjen në njoftimin e Gjykatës Kushtetuese së bashku me dokumentacionin shtesë duke sqaruar vendimet e tyre të mëhershme si dhe duke ofruar dokumente që e mbështesin vendimin e tyre, së bashku me provat se të njëjtat kritere janë zbatuar edhe ndaj subjekteve tjera politike.

Përmbledhja e fakteve

11. KZAP-i më 25 janar 2010 e mori një ankesë me Nr. 358 nga ZRPPC-ja pranë KQZ-së ku theksohet se subjekti politik UBK nuk ka paraqitur raport për gjendjen financiare në zyrat e ZRPPC-së si dhe 27 subjektet tjera politike gjë që kërkohet në bazë të neneve 40.5 dhe 119.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe në bazë të nenit 6.6 të Rregullës së Zgjedhjeve nr. 12/2009. Këto Rregulla parashikojnë që secili subjekt i regjistruar politik është i obliguar që të paraqesë

raportin financiar për rundin e parë zgjedhor deri më 31 dhjetor 2009 dhe për rundin e dytë deri më 7 janar 2010.

12. Një ankesë të tillë të ZRPPC-së pranë KQZ-së, KZAP-i ia dërgoi UBK-së më 15 shkurt 2010 në mënyrë që të mund të përgjigjet në lidhje me pretendimet e cekura në ankesë deri më 18 shkurt 2010.
13. Paditësi UBK pohon se nuk e ka pranuar fare kopjen e ankesës që e kishte dërguar KZAP-i dhe për këtë arsye as që ka pasur mundësi të përgjigjej.
14. Duke vendosur lidhur me këtë ankesë që e ka paraqitur ZRPPC-ja pranë KQZ-së, KZAP në seancën e mbajtur më 23 shkurt 2010 mori vendimin A nr. 87/2010 me të cilin subjekti politik UBK u dënua me gjobë në shumën prej 1500 eurosh me arsyetimin se është shkelur neni 40.1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.
15. Të pakënaqur me një vendim të tillë UBK, në Prizren, ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës që të anulojë vendimin për dënim me gjobë me kërkesë që të shfuqizohet vendimi i KZAP-it A. Nr. 87/2010 i 23 shkurtit 2010 dhe që rasti të kthehet për rishqyrtim si dhe që ankesa e ZRPPC-së të refuzohet si e pabazuar.
16. Duke vendosur në lidhje me ankesën e UBK-së Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e mbajtur më 27 maj 2010 e hodhi poshtë ankesën e UBK-së si të papranueshme duke iu referuar nenit 118.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme sipas të cilit pala mund të paraqesë ankesë në Gjykatën Supreme vetëm nëse shuma e gjobës është më e lartë se 5000 euro.
17. Pasi që UBK nuk e ka paguar gjobën e shqiptuar, KZAP i cili me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 03/L-256 për Zgjedhjet e Përgjithshme e ka ndërruar emërtimin në Panel Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejme: "PZAP") më 28 shkurt 2011 i dërgoi UBK-së vërejtjen për të paguar gjobën e shqiptuar më parë.

Pretendimet e palës kundërshtare

18. Më 6 prill 2011 KZAP-i ka sqaruar se me korrespondencën Nr. A87/R1-2010, të 15 shkurtit 2010, dërguar ZRPPC-së të KQZ-së, ajo Zyrë i dha mundësinë UBK-së që të deklarohej rreth pretendimeve të ankesës së ushtruar nga ana e ZRPPC-së kundër këtij subjekti politik në lidhje me raportin financiar.
19. KZAP-i pohon se deri më 18 shkurt 2010 sekretariati i KZAP-it nuk kishte marrë ndonjë përgjigje nga UBK-ja.
20. Në po të njëjtën përgjigje KZAP-i pohon se përmendja e subjektit politik të JSŽ-së ka qenë lëshim teknik me rastin e përkthimit të tekstit nga gjuha shqipe në atë serbe.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pohon se vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me të cilin u miratua ankesa e ZRPPC-së dhe u gjobit subjekti politik UBK, është në kundërshtim me Kushtetutën, duke mos specifikuar konkretisht se cilat nene të Kushtetutës pretendohet të jenë shkelur.
22. UBK pohon se vendimi i PZAP-it duke përmendur JSŽ-në në arsyetimin e tij është konfuz dhe i paqartë, dhe se ata nuk e kishin marrë fare ankesën e ZRPPC-së dhe kësaj nuk kanë mundur t'i përgjigjen asaj.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

23. Për të qenë në gjendje për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të Punës së Gjykatës Kushtetuese.

24. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

25. Fillimisht, Gjykata konsideron se sipas nenit 21.4 të Kushtetutës, i cili parashikon që “Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke kërkuar të drejtat themelore të cilat vlejné për individët si dhe për personat juridikë, siç është dhe parashtruesi i kërkesës. Kjo do të thotë se parashtruesi i kërkesës e ka të njëjtin obligim që të respektojë afatet kohore të parapara me Ligj, siç përcakton Neni 113.7 për individët.

26. Neni 49 i Ligjit i cili përcakton afatet kohore për parashtrimin e kërkesave individuale sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 të Ligjit si në vijim:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht.”

27. Kërkesa e parashtruesit është dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese më 8 mars 2011, ndërsa vendimi i fundit në lidhje me këtë rast është nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës më 27 maj 2010 i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 30 qershor 2010 (shih dosjen e lëndës, dëshmi fletëkthimi). Në bazë të kësaj, Gjykata konkludon se kërkesa është dorëzuar pas afatit dhe si e tillë, nuk është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit.

28. Edhe po që se Gjykata do të aplikonte afatet në raport me aktvendimin e PZAP-it A. Nr. 87/2010 të 23 shkurtit 2010, kërkesa do të ishte e paraqitur pas kalimit të afatit. Prandaj ajo nuk është në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit.

29. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave në lidhje me objektin e çështjes, dhe pas këshillimit për këtë çështje, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte dorëzuar pas afatit prej 4 muajsh, nga dita kur vendimi i fundit i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullat 36 (1b) dhe 56 (2) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 07 korrik 2011, njëzëri


VENDOS

- i. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- ii. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- iii. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani